



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr 58 prot.


Tiranë, më 15, 04 2010

VENDIM Nr. 70, dt. 06.04.2010

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), të VKM Nr. 725, datë 21.05.2008, "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 06.04.2010,

VENDOSI:

- I. Bazuar në vëzhgimin intensiv arkeologjik realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni, të miratojë projektin e gjurmës së re të rrugës "Bypass-it Fier - Levan", paraqitur nga "Koopercioni Italian", me kushtet e mëposhtme:
 1. Në Zonat nga KM 10+650 – KM 11+150 dhe nga KM 16+400-KM 16+700, është e domosdoshme të kryhen sondazhe arkeologjike nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me institucionet e tjera.
 2. Është e domosdoshme prezenca e ekspertëve arkeologë gjatë zbatimit të punimeve rrugore.
 3. Punimet për këtë segment rrugor, edhe në zonat ku nuk është vërejtur potencial arkeologjik, do të mbikqyren nga ekspertë



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

arkeologë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Zyrës së Administrimit
Koordinimit të Parkut Arkeologjik, Apoloni.

4. Një kopje me konkluzionet e arritura për ndryshimet në projektin e gjurmës së re të "Bypass-it" të rrugës "Fier – Levan", t'i përcillet përfaqësuesve të "Kooperacionit Italian".
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

FERDINAND XHAFERAJ



SEKRETARI I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK